

Ky është një mesazh nga Superintendent Binienda. Po telefonoj për të ndarë me ju disa përditësime të rëndësishme.

Shkollat Publike Worcester kanë dërguar sondazhe për mësimin në distancë tek nxënësit dhe stafin përmes adresave tuaja të emailit. Sondazhi i prindërve është duke u përkthyer dhe do të publikohet në mediat sociale dhe gjithashtu do të publikohet edhe në faqen e internetit të Shkollave Publike Worcester të Hënën, 15 qershor 2020. Sondazhi shtron pyetje në lidhje me mësimin në distancë dhe komunikimin nga stafi gjatë mbylljes së Covid 19. Ju lutemi merrni kohën e nevojshme për të plotësuar këtë sondazh pasi ne do t'i përdorim këto informacione për të informuar mësimdhënësit për vitin shkollor 2020-2021.

Programet Virtuale të Shkollës Verore për nxënësit nga Kopshti deri në klasën e 12 janë publikuar në faqen e internetit të Shkollave Publike Worcester, Worcesterschools.org. Formularët e regjistrimit mund të plotësohen në faqen e internetit. Prindërit gjithashtu mund të kontaktojnë drejtorin e shkollës dhe / ose mësuesin për regjistrim. Shkolla verore për shumicën e programeve fillon të Mërkurën e ardhshme 17 Qershor. Nxënësit duhet të regjistrohen këtë javë për në shkollën verore virtuale. Programet e Edukimit Special fillojnë në 6 Korrik.

Sajti për Mësimin e Zgjeruar i Shkollave Publike Worcester, përfshirë Programet e Matematikës ST dhe Lexia, për Kopshtin deri në Klasën e 6 janë në dispozicion për përdorim nga nxënësit gjatë gjithë verës. Karta e raportit të fëmijës tuaj do të postohet. Të përfshira në këto zarfe do të jenë edhe Raportet e Progresit të Edukimit Special, informacione rreth vendeve të ushqimit të verës dhe APPS të disponueshme për të gjitha klasat për përdorim falas nga nxënësit gjatë verës.

Unë kam bërë shumë biseda me stafin e Shkollave Publike Worcester, dhe me nxënësit dhe familjet gjatë javës së kaluar pas vrasjes së pakuptimtë të George Floyd. Ata ndanë histori zemërimi, frike dhe lëndimi dhe të gjithë diskutuan qëllimin e përbashkët të një komuniteti shkollor pa racizëm dhe intolerancë. Stafi i Shkollave Publike Worcester ndau angazhimin e tyre për të ofruar mundësi arsimore për sukses për të gjithë nxënësit tanë. Dua të ndaj me ju që Shkollat Publike Worcester janë të angazhuara të sigurojnë që çdo fëmijë të ketë akses në mësim dhe lulëzon në një kulturë pa racizëm dhe paragjykime. Ne e pranojmë që duhet të ofrojmë mbështetje dhe trajnim shtesë për nxënësit dhe stafin tonë. Shkollat Publike Worcester do të zgjerojnë trajnimet që filluan në vitin shkollor 2019-20: trajnim për Traumën dhe rezistencën nga Dr. Heather Forkey, nga Qendra e Traumës UMASS; Praktikat e Kompetencave Kulturore për të adresuar program mësimor gjithëpërfshirëse; dhe Bashkëpunimi për Zgjidhjen e Problemeve për të adresuar përgjigjen e stafit ndaj disiplinës së nxënësve. Pozicioni i Shefit të Diversitetit do të fillojë në 1 Korrik 2020. Ivonne Perez, Shefja jonë e Diversitetit, ka një mandat të suksesshëm në WPS si Drejtore e Shkollës Chandler Magnet. Zonja Perez do të përqendrohet në ndërtimin e një kulture të fortë të njohjes dhe vlerësimit të diversitetit, përfshirë rritjen e diversitetit në fuqinë punëtore, pasi ne e dimë që nxënësit mësojnë më mirë kur kanë mësues të kualifikuar që përfaqësojnë komunitetin e tyre.

Komisioneri i Arsimit më vonë gjatë Qershorit do të japë më shumë informacione lidhur me rihapjen e shkollave në Gusht. Unë do t'ju kontaktoj gjatë verës për më shumë përditësime.

Dua të falënderoj prindërit dhe kujdestarët e Shkollave Publike Worcester për punën tuaj bashkëpunuese me stafin tonë të Shkollave Publike Worcester gjatë kesaj mbyllje. Ju uroj juve dhe fëmijëve tuaj një verë relaksuese.

Me Respekt,

Maureen Binienda